



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:213008

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753515

KPPP.nr.1628/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “Termo Dinamic” Sh.P.K., me adresë në fshatin Muzeqinë, Komuna e Shtimes, me NUI: 811272773, kundër debitorit “Orienti Group” Sh.P.K., me adresë në rr. “Nëna Tereza” në Fushë Kosovë, me NUI: 811368514, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.145/2022 të datës 06.05.2022, të lejuar nga Përbaruesi Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Orienti Group” Sh.P.K, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.145/2022 i datës 06.05.2022, i Përbaruesit Privat Mubarak Shumolli, për pjesën e detyrimit në shumën prej 28,260.00 €.
- II. REFUZOHET prapësimi i debitorit “Orienti Group” Sh.P.K., dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr.145/2022 i datës 06.05.2022, të Përbaruesit Privat Mubarak Shumolli, sa i përket shumës prej 1,080.00 € së bashku me kamatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “Termo Dinamic” Sh.P.K., ndaj debitorit “Orienti Group” Sh.P.K., sipas Urdhrit Përbarimor P.nr.145/2022 të datës 06.05.2022, për shumën prej 28,260.00 €.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbauesim të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbauesimor P.nr.13/2023, të datës 06.03.2023, me të cilin ka lejuar përmbauesimin, në bazë të dokumenteve të besueshme: Faturës nr.01/2019 të datës 26.02.2019, Faturës nr.02/2019 të datës 04.03.2019, Faturës nr.03/2019 të datës 11.04.2019, Faturës nr.04/2019 të datës 11.04.2019, Faturës nr.05/2019 të datës 09.08.2019, Faturës nr.06/2019 të datës 22.08.2019, Faturës nr.07/2019 të datës 26.08.2019, Faturës nr.08/2019 të datës 17.09.2019, Faturës nr.01/2020 të datës 08.07.2020, Faturës nr.02/2020 të datës 21.08.2020, Faturës nr.03/2020 të datës 03.09.2020, Faturës nr.04/2020 të datës 26.09.2020, Faturës nr.05/2020 të datës 03.10.2020, Faturës nr.06/2020 të datës 16.10.2020, Faturës nr.07/2020 të datës 26.10.2020, Faturës nr.08/2020 të datës 02.11.2020, Faturës nr.09/2020 të datës 02.11.2020, dhe Faturës nr.10/2020 të datës 25.11.2020, duke urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t'i paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 29,340.00 €, me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e përmbauesimit, nën kërcënimin e përmbauesimit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbauesimor për shkak se dokumenti në bazë të të cilit është marr urdhri nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbaueshmërisë. Më tej ka theksuar se fatura nr.01/2020, fatura nr.02/2020, fatura nr.03/2020, fatura nr.04/2020, fatura nr.05/2020, fatura nr.06/2020, fatura nr.07/2020, dhe fatura nr.08/2020 janë paguar nga e debitorit, dhe këtë e dëshmojnë transaksionet bankare. Po ashtu, fatura nr.04/2020 dhe fatura nr.05/2020 i është përmbushur kreditorit në formë të kompensimit dhe atë me dërgimin e mallit nga "Orienti Group" Sh.P.K., ku e dëshmojnë edhe fletëdërgesat e datës 11.11.2020, ndërsa pjesa e mbetur prej 300 Euro është përfshirë në transaksionin e datës 19.04.2021. Ka shtuar se kreditori faturën nr.09/2020 nuk e ka bashkangjitur në shkresat e lëndës, ndërsa fatura nr.10/2020 nuk është e pranuar nga debitori dhe nuk i ka tiparet e titullit përmbauesimor. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovet si i bazuar, ndërsa urdhri përmbauesimor të anulohet, si dhe të detyrohet kreditori që t'ia paguaj debitorit shpenzimet e përpilimit të prapësimit.

Kreditori, nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vendosi sikur në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke anuluar pjesërisht Urdhrin për lejimin e përmbartimit për pjesën sa i përket faturave: Faturës nr.01/2019 të datës 26.02.2019, Faturës nr.02/2019 të datës 04.03.2019, Faturës nr.03/2019 të datës 11.04.2019, Faturës nr.06/2019 të datës 22.08.2019, Faturës nr.07/2019 të datës 26.08.2019, Faturës nr.08/2019 të datës 17.09.2019, Faturës nr.01/2020 të datës 08.07.2020, Faturës nr.02/2020 të datës 21.08.2020, Faturës nr.03/2020 të datës 03.09.2020, Faturës nr.04/2020 të datës 26.09.2020, Faturës nr.05/2020 të datës 03.10.2020, Faturës nr.06/2020 të datës 16.10.2020, Faturës nr.07/2020 të datës 26.10.2020, Faturës nr.08/2020 të datës 02.11.2020, Faturës nr.09/2020 të datës 02.11.2020, Faturës nr.10/2020 të datës 25.11.2020, pasi që për faturën nr.01/2020 të datës 08.07.2020, Faturën nr.02/2020 të datës 21.08.2020, Faturën nr.06/2020 të datës 16.10.2020, Faturën nr.08/2020 të datës 02.11.2020, Faturën nr.07/2020 të datës 26.10.2020, dhe Faturën nr.03/2020 të datës 03.09.2020, nga transaksionet bankare, rezulton se detyrimi në lidhje me këto fatura është përmbushur nga debitori. Ndërsa, sa i përket faturave tjera, përkatësisht faturës nr.03/2019, faturës nr.09/2020, faturës nr.10/20, faturës nr.03/2019, faturës nr.04/2019, faturës nr.05/2019, faturës nr.06/2019, faturës nr.07/2019, faturës nr.08/2019, të njejtat nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme në kuptim të nenit 29. par.3 të LPP-së, për faktin se të njejtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranimit-debitorit, prandaj, faturat e lartcekura nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë përderisa rezultojnë të jenë lëshuar njëanshëm nga kreditori.

Gjatë vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbartimor për borxhin që rrjedh nga fatura nr.04/2020 e datës 26.09.2020, dhe fatura nr.05/2020 e datës 03.10.2020, në shumën e përgjithshme prej 1,080.00 €, pasi që këto fatura i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së, ngase në secilën nga këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara qartë shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, faturat janë dorëzuar në origjinal, dhe këto fatura janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt fakt ky i cili vërtetohet përmes nënshkrimit të debitorit.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i Përmbartuesit Privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përmbartimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 13,359.53 Euro, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1628/23 më datë 27.05.2024

Gjyqtari
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7)ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.